



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0284**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Adem Pireva B.I., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-së me numër të prokurimit 214-23-3155-2-2-1, me 24/07/2023, mori:

### **Vendim**

**1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Adem Pireva B.I.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 19.05.2023 (me numër protokolli 284/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-se “ me nr. të prokurimit: "214-23-3155-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves.

**2. Të anulohet**njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 04.04.2023, Policia e Kosoves, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-se” me nr. të prokurimit: "214-23-3155-2-2-1". Nderkaq me datën 05.05.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Adem Pireva B.I.” me datën 06.05.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 12.05.2023, AK- Policia e Kosovës me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Adem Pireva B.I” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-se” me numër të prokurimit “214-23-3155-2-2-1” të inicuar nga Policia e Kosovës.

AK me vendim ka kërkuar të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhënie të AK –Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Riparimi i pjesëve për automjetet e PK-se” me numër të prokurimit “214-23-3155-2-2-1”.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Adem Pireva B.I” me datën 19.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 284/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 70.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

#### ***- Vlerësimi dhe administrimi i provave –***

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 29.05.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Adem Pireva B.I”.

**Të aprovet si e bazuar**, si dhe **të anulohet** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

#### **PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES**

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 70,000.00 €. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të operatorit ekonomik ankues.

Në bazë të formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues-Policia e Kosovës të dt:05.05.2023, AK anulon aktivitetin e prokurimit. Ndërsa përmes letrës standarde për

tenderuesin e eliminuar OE “Adem Pireva B.I” të datës 04.05.2023, ka potencuar: Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm: me arsyetimin:

*“Te kjo ofertë-Adem Pireva B.I Prishtinë, konkretisht te “Deklarata nen Betim” janë kërkuar te dhënat e OE: Emri dhe Mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula që të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik ne rastin konkret nuk është plotësuar dhe nënshkruar nga Adem Pireva-pronari i kompanisë, ndërsa është plotësuar nga personi qe nuk është kompetent dhe i autorizuar konkretisht nga Muhamet Pireva që ky person në fjalë nuk ka autorizim në ofertë për të përfaqësuar këtë kompani. “*

Kundër arsyetimit të eliminimit, OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim ku AK- Policia e Kosovës, përmes vendimit te datës 12.05.2023, refuzon kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, njoftimit të AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe pretendimeve të OE ankues, se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, dhe 62 të LPP-së, si dhe nenin 38 dhe 43 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, OE ankues potencon se gjatë ofertimit ka ndodhë një lëshim teknik me ç’rast nuk është bashkangjitur autorizimi i personit të autorizuar. OE ankues potencon se autorizimi mban datën para hapjes së ofertave dhe si i tillë duhet të merret parasysh dhe të konsiderohemi OE i përgjegjshëm. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK tek Kërkesat e përshtatshmërisë ka kërkuar:

<b>Kërkesat e përshtatshmërisë:</b>	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b>
<b>a)Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092,do të dorëzohen në formë të Aneksit 2</b>	<b>a) Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 – origjinal.</b>

Sqarojmë se në ofertën e parashtruesit të ankesës, rezulton qe i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur deklaratën nën betim të nënshkruar nga personi Muhamet Pireva, ndërsa pronar i biznesit është Adem Pireva. Megjithatë, në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesën e parashtruar në OSHP nga OE ankues është bashkangjitur kopja e aktit noterial përmes të cilit autorizohet z. Muhamet Pireva që të ta përfaqëson në të gjitha organet Komunale Kadastrale, Administrative, ATK, Gjykatave, para Noterit, Doganave, Organeve Policore dhe Ministrive përkatës, si dhe para të gjithave organeve tjera Shtetërore Kompetente, etj. Akti noterial përmes të cilit është autorizuar z. Muhamet Pireva nga Adem Pireva B.I. mban numrin **LRP. Nr. rendor: 3494/2020**. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në bazë të kësaj kopje të aktit noterial, e cila është bashkangjitur nga operatori ekonomik ankues Adem Pireva B.I në kërkesën për rishqyrtim dhe ne ankesën e parashtruar në OSHP me numër **LRP. Nr. rendor: 3494/2020**, rezulton se ky autorizim është para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve,

përkatësisht me datë 11.03.2020.

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se edhe vetë OE ankues e pohon se në ankesë nuk ka bashkëngjit autorizimin e aktit noterial për përfaqësim të personit i cili ka dorëzuar ofertën. Lidhur me këtë, **ekspertja shqyrtuese sqaron** se operatorët ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit janë përgjegjës për ngarkimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara në sistemin e prokurimit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve për të dëshmuar se plotësojnë kërkesat dhe kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit. Këtë konstatim, **ekspertja shqyrtuese** e bazon në nenin 32, par. 32.4 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik. Megjithatë, AK ka mund që të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues pasi që parashtuesi i ankesës se bashku me kërkesën për ri shqyrtim e ka prezantuar kopjen e autorizimit të aktit noterial, ku është dhënë autorizimi për përfaqësim të personit i cili ka dorëzuar ofertën, dhe njëheri autorizim mban datën para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve, megjithatë, autoriteti kontraktues dëshminë e tillë nuk e ka trajtuar si të mirëqene. **Ekspertja shqyrtuese** konsideron se AK gjatë ri vlerësimit mundet të kërkoj informata shtesë të verifikoj aktin noterial se a është i autorizuar z.Muhamet Pireva, të përfaqëson në emër të biznesit NSHT “Pireva” por duke u siguruar që ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet, ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive konform nenit 72.3 të LPP-së.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, gjithashtu anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

#### *- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e

ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij.

*- Përfundim -*

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe nuk ka zbatuar drejtë nenin 59 të LPP. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Adem Pireva B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: